

PROBLEME AKTUALE TË FOLKLORISTIKËS SHQIPTARE

Arbnora DUSHI
Instituti Albanologjik
Prishtinë

Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër: Në këtë punim do të përpiqem të shoh statusin e disiplinës së Folkloristikës, (si disiplinë akademike për studimin e folklorit) sot, në krahasim me të kaluarën kur ajo u themelua dhe u zhvillua deri në gjendjen që e njohim. Duke i analizuar rrethanat, aspak të favorshme, në të cilat ajo funksionon sot, si edhe duke ofruar shembuj nga praktika vendore dhe ndërkombëtare, do të mundohem të nxjerr mundësi për të ndryshuar këtë gjendje. Një ndryshim i statusit të saj për të mirë, është i domosdoshëm kur dihet se vetë lënda e studimit të saj (folklori) krijohet në vazhdimësi, përderisa disiplinës së studimit, folkloristikës, çdo herë e më shumë po i ngushtohet hapësira e veprimit. I nevojshëm është edhe ndryshimi i qasjes teorike, duke e mundësuar kështu lëvizjen e fokusit nga “studimi i së kaluarës” tek “proceset e reja bashkëkohore”. Idetë për ndryshime vazhdojnë të mbesin të hapura, pasi që ndryshimet nga brendia kërkojnë vullnetin, gatishmërinë dhe përgatitjen profesionale të grupit, jo të individit.

Hyrje

Kur prof. Anton Çetta e mori detyrën që të themelojë Degën e Folklorit në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ai kishte vite që ligjëronte si profesor në Fakultetin e Filologjisë në UP. Atëherë “fondi i letërsisë popullore mendohej si diçka abstrakte dhe nuk dihej se çfarë pasurish të

këtij arti ka terreni”¹. Ai e hartoi projektin për mbledhjen dhe botimin e 25 blejve të gjinive dhe llojeve të letërsisë popullore, materiale këto që duhej t’i përgatiste Dega e Folklorit dhe kjo ishte edhe detyra parësore e kësaj dege, pasi që në atë kohë (fundi i viteve ’60) pa sigurimin e lëndës në arkiv, ishte e pakuptueshme vetë Folkloristika si disiplinë. Për të kryer këtë detyrë, ai së pari zgjodhi bashkëpunëtorët e brendshëm të Degës, si edhe e krijoi rrjetin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, kryesisht ish-studentë të tij dhe intelektualë, të cilët eksploronin material folklorik dhe e sillnin në Degën e Folklorit². Kjo punë kaq e organizuar, rezultoi me botimin e tërë atyre materialeve të mbledhura, punën më të madhe në përgatitjen e të cilave e bëri prof. Çetta me studentët, kolegët dhe bashkëpunëtorët. Përveç mbledhjes, redaktimit dhe botimit të materialeve në formë të blejve, këta hulumtues, që me kohë dhe me punë i morën gradat shkencore dhe e fituan statusin e studiuesve, punuan me këto materiale të botuara, duke u marrë më pas me poetikën e këtyre zhanreve të mbledhura, punë kjo e cila rezultoi me botimin e disa monografive³. Kjo është, në vija të trasha, mënyra siç u punua me folklorin, pra si u krijua bazamenti i Folkloristikës shqiptare në Kosovë, nëpërmjet organizimit të punës në inatitucion shkencor, respektivisht nëpërmjet veprimtarisë hulumtuese e shkencore në Degën e Folklorit.

Folkloristika që mori hov nga ky bazament u zhvillua për vite me radhë sipas këtij modeli, dhe në fillim ajo lëvizte sipas modeleve të njëjta apo edhe të përafërta në kulturat e tjera në ish-Jugosllavi, modele këto që nuk ishin larg edhe nga ai në Shqipëri. Mirëpo me kalimin e viteve dhe pas një pune të madhe që u bë dhe po bëhej për mbledhjen, transkriptimin dhe botimin e këtyre materialeve, Folkloristika shqiptare në Kosovë po rrezikonte të mbetej vetëm në domenin e mbledhjes dhe regjistrimit të gjendjes në terren, por jo edhe të përcjelljes së hapave të zhvillimeve të metodave dhe qasjeve të reja analitike, komparativiste, multidisiplinare e metodave të reja që depërtonin çdo ditë në folkloristikat evropiane e botërore. Pse po ndodhte kjo dhe ku ishin shkaqet? Rrethana të shumta qenë ato që e orientuan rrugën e Folkloristikës shqiptare në Kosovë, duke

¹ Rrustem Berisha, Ndihmesa e Anton Çettës për punën e Degës së Folklorit, *Anton Çetta, figurë poliedrike e kulturës shqiptare*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011, fq.142.

² Myzafere Mustafa, Kontributi i prof. Anton Çettës në mbledhjen dhe studimin e letërsisë gojore, *Anton Çetta, figurë poliedrike e kulturës shqiptare*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011, fq. 127.

³ Shih më tepër, Tridhjetë vjet të Institutit Albanologjik (1967-1997), Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1997, fq. 111.

hyrë këtu rrethanat historike, politike, ekonomike, kulturore madje edhe deri edhe në shkëputje të madhe nga proceset e mirëfillta shkencore e akademike, kur e kemi parasysh periudhën 1989-1999. Shkëputjet e mëdha dhe ndërprerjet e shpeshta nga rrjedhat e proceseve edukative e shkencore, pra edhe nga ato të trendëve akademike, bënë që studimet e folklorit shqiptar të jenë tepër pak, për të mos thënë aspak, të pranishme në folkloristikën evropiane e botërore. Madje edhe kur shohim sot 15 vite pas luftës në Kosovë, vërejmë se edhe në këtë kohë, të rrethanave të reja, vazhdojmë të jemi larg këtyre zhvillimeve, dhe vërejmë se Folkloristikën shqiptare vazhdon ta përcjellë një ngecje, një mosgatishmëri për të përcjellë hapin e zhvillimeve të kësaj disipline në rajon e përreth. Vazhdojmë të sillemi dhe veprojmë brenda kornizave të kufizuara të vetes sonë, vazhdojmë të vetëmjaftohemi me të arriturat tona dhe asnjëherë të mos synojmë të krahasohemi me të tjerët, të matemi me të tjerët, apo edhe t'i studiojmë të tjerët. Në bibliotekat tona, përkundrejt një kohe, para viteve '90 kur furnizoheshim rregullisht me botimet e fundit, origjinale por edhe të përkthyer nga fushat e ngushta profesionale (që botoheshin në ish-Jugosllavi, por edhe më gjerë), sot mungojnë në masë të madhe botimet, librat dhe revistat shkencore që publikohen jashtë. Ne nuk arrijmë të përcjellim trendët e reja të teorive dhe të metodave që e zhvillojnë në vazhdimësi folkloristikën evropiane dhe botërore. Përveç librave që botohen në Shqipëri, të cilat arrijnë të zënë vend në bibliotekat tona, të tjerat nuk kemi mundësi t'i shohim. Këto botime nuk arrijnë tek ne as në origjinal as të përkthyer. Gjithashtu ne nuk arrijmë as të kemi qasje në revistat ndërkombëtare ku botohen artikujt shkencorë dhe ku do të mund të prezantoheshim edhe ne me punimet tona. Përveç një mundësie të vogël që e kemi krijuar nëpërmjet librarisë virtuale CEEOL, të cilën krahas mundësisë për qasje në revistat e shkencave sociale që plasohen aty, edhe ne i dërgojmë rregullisht tri seritë e revistës "Gjurmime albanologjike", në të tjerat nuk arrijmë të kemi qasje. Si rrjedhim i kësaj gjendjeje edhe botimet tona nuk arrijnë të përkthehen dhe as të arrijnë tek studentët e studiuesit joshqiptarë. Ne vazhdojmë të jemi të izoluar dhe kështu të mos kemi mundësi të përcjellim trendët zhvillimeve në botë, përveç ndoshta me ndonjë përjashtim të vogël individual. Sillemi rreth vetes sonë, rreth hulumtimeve dhe studimeve tona dhe mjaftohemi ta shohim dhe përcjellim veten. Në këtë mënyrë nuk arrijmë as të shohim se ku jemi?! Prandaj nëse veç pak ndalemi të merremi me këtë çështje e shohim se Folkloristika shqiptare në Kosovë, duke mos e përjashtuar shumë edhe atë në Shqipëri, po përjeton një krizë të metodologjisë hulumtuese shkencore duke rrezikuar kështu të mbetet në margjinë si

disiplinë akademike, përderisa simotrat e saj në Evropë, por edhe në rajon, kanë shkuar shumë larg. Atëherë, ndoshta është mirë të provojmë ta shohim disiplinën e folklorit shqiptar në përfaqje me këto raporte dhe të kërkojmë zgjidhjen e dilemave: Çka e karakterizon sot Folkloristikën shqiptare? Cilat janë rrethanat e zhvillimit të kësaj disipline akademike? Çfarë janë metodat e hulumtimit dhe studimit të folklorit? Cili është definicioni që mbizotëron sot për folklorin shqiptar? Cili është vendi i kësaj disipline në programet universitare? Ku dhe si ndërtohen folkloristët shqiptarë? A nxjerrin universitetet tona folkloristë apo të tillët duhet të krijohen vetë? Si qëndrojnë raportet me disiplinat, por edhe me departamentet e tjera akademike? Si edhe të shohim se: cilat janë modelet e zhvillimit të kësaj disipline në kulturat e tjera, në rajon dhe më gjerë?

Emërtimi, koncepti, definimi

Folkloristika shqiptare në Kosovë, si institucion akademik, sot vepron vetëm në Institutin Albanologjik në Prishtinë, me emrin *Dega e Folklorit*. Këtë emër ajo e mori me themelimin e saj në fund të viteve '60 atëherë kur puna që filloi të bëhej aty ishte mbledhja, regjistrimi dhe botimi i folklorit shqiptar, pra emrin e mori sipas materies hulumtuese, sipas lëndës së punës, por jo sipas disiplinës hulumtuese, sipas punës që bëhej me atë lëndë - folkloristikës. *Departamenti i Folkloristikës* do të ishte termi që do të përkufizonte më saktë këtë veprimtari, i cili do të ishte edhe në harmoni me emërtimet e degëve (departamenteve) të tjera në këtë Institut: *Dega e Gjuhësisë*, por jo e Gjuhës; *Dega e Letërsisë*, por jo e Librit; *Dega e Historisë* por jo e Dokumenteve; *Dega e Etnologjisë* por jo e Etnisë apo e Traditës, emërtimet e të cilave vërehet se janë bazuar mbi disiplinën e jo mbi lëndën hulumtuese, siç është bërë me *Degën e Folklorit*.

Në këtë departament, siç edhe u theksua pak në fillim, që nga themelimi me në krye prof. Anton Çettën, u angazhuan studentët e tij nga Dega e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, në cilësinë e asistentëve në fillim e më pastaj të bashkëpunëtorëve profesionale shkencorë. Këta punonjës shkencorë u ndërtuan si folkloristë profesionistë nëpërmjet punës hulumtuese shkencore në terren dhe nëpërmjet punës kabinetike në transkriptimin e materialeve (sepse departamenti nuk pati asnjëherë një punëtor profesionist që do të transkriptonte materialet gojore të mbledhura, por gjithmonë këtë punë u desh ta bënin vetë punonjësit shkencorë), analizimin dhe studimit të njësive të mbledhura, shumë prej të cilave rezultuan me studimin e

poetikave të këtyre njësive. Në vitet produktive të këtij departamenti, folklori si lëndë hulumtuese dhe folkloristika si disiplinë që merret me trajtimin e kësaj materieje, nuk dallonin për nga emërtimi. Një unitet i këtillë mbizotëronte edhe në kultura të tjera, ku me folklorin shumë herë emërtohej edhe vetë disiplina e tij, pra Folkloristika. Folklori, lënda, konsiderohej prodhimi shpirtëror, vetëm gojor (verbal), (duke përfshirë në këtë domen edhe muzikën popullore), i traditës popullore, kryesisht rurale. “Letërsia popullore është formë e krijimit artistik që shprehet me anë të fjalës së gjallë. Këtë formë, gjatë shekujve, e kultivoi, e zhvilloi dhe e orientoi fare mirë tradita e të shprehurit gojor të popullit të pashkolluar dhe kjo është kultura e përgjithshme e secilit popull veç e veç.”⁴ Tri ishin kryesisht veçoritë që e cilësonin lëndën e folklorit:

1. të jetë gojor, i shprehur me gojë pa lidhje me shkrimin;
2. të jetë tradicional, pra të jetë i bartur nëpër gjenerata nëpërmjet kujtesës, vetëm orale; dhe
3. të jetë i lidhur me fshatarësinë, me traditën e kulturës rurale.

Folklor asnjëherë nuk konsiderohej prodhimtaria shpirtërore urbane. Tradita qytetare nuk përfshihej në hulumtim. Gjithashtu në hulumtim nuk përfshihej asnjëherë gojorja jo tradicionale, p.sh. përvoja personale, e cila nuk vinte si rezultat i një përvoje të brezit ose brezave të kaluar, pra as ajo nuk hynte në domenin e folklorit. Po ashtu, nëse një subjekt i terrenit e kishte mësuar nga librat, këngën, përrallën apo cilindo lloj tjetër që e këndonte, tregonte, recitonte, ai asnjëherë nuk merrej parasysh nga hulumtuesit folkloristë. Kjo mbetet dije (ang. Lore) e mësuar nga rruga e shkrimit, por jo e bartjes me gojë, prandaj mbetet jashtë nga folklori. “Folklori ashtu si mitet, ekziston në trajtë ligjërimit, sepse i nënshtrohet mekanizimit të transmetimit gojor, kurse veprat e letërsisë së kultivuar fiksohen në mënyrë të paluajtur në dokumente të shkruara”⁵.

Në rrjedhim nga cilësitë e sipërpërmendura, nënkuptohet se veçoritë karakterizuese të lëndës së folklorit, ishin shumë të kufizuara dhe kështu ajo që i cilësonte ishte gjithmonë kërkesa për “folklor të mirëfilltë”, për folklor gjenuin, folklor “cilësor”, me çka zhvillohej ideja për një koncept “puritan” të folklorit. Ky koncept, që e mbizotëroi Folkloristikën shqiptare që nga fillimi, konsistonte në “pastërtinë” e folklorit, në atë që quhet “vlerë e mirëfilltë”, duke qenë në njëfarë forme “diskrimi-

⁴ Demush Shala, *Letërsia popullore*, ETMM i KSAK, Prishtinë, 1988, fq.7.

⁵ Alfred Uçi, *Estetika e Folklorit*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2007, fq.40.

nues” ndaj formave të ndryshme shprehëse të shpirtit krijues të masës, të cilat pavarësisht se nuk “preferoheshin” nga folkloristët ato paraqesin materien krijuese, shpirtin e individit dhe të masës. E në të vërtetë është ky shpirt ai që do të duhej t’i orientonte hulumtuesit e studiuesit, e jo këta të fundit ta orientonin materien. Folkloristët duhet të shkojnë pas njerëzve, pas lëndës krijuese, e jo e kundërta dhe është lënda (folklori) ajo që e dikton metodologjinë e hulumtimit (folkloristikën). Madje në këtë kontekst, shumë herë edhe vetë folkloristët, nuk përjashtoheshin nga të qenit subjekte hulumtimi në terren, duke i dhënë kështu kuptim gjithçkaje që na rrethon, përfshirë edhe veten, si lëndë krijuese por edhe hulumtuese për folklorin. Apo nuk ka thënë Alen Dundes (Alan Dundes) “Kush e përbën popullin (folkun)? Midis të tjerëve edhe ne”⁶. Kur jemi në këtë pikë, problemi rritet kur dihet fakti se edhe sot pas gati pesëdhjetë vitesh veprimtarie të kësaj Dege (departamenti), koncepti për folklorin, respektivisht për folkloristikën, vazhdon të mos jetë i reformuar. Ai vazhdon të mbetet i tillë, i tkurrur, duke bërë kështu që folklorit t’i pranohet vetëm ana letrare, pra vetëm ajo poetike, dhe kështu folklor të konsiderohet vetëm *Letërsia popullore*, ose *Letërsia gojore*, pra vetëm aspekti letrar i saj, por asnjëherë ai të shihet për tërësinë e tij shprehëse gojore, si shprehje edhe kulturore, edhe tradicionale, edhe regjionale, edhe kontekstuale, edhe nga aspekte të tjera jashtë letrare. Studimet që i bëhen folklorit sot, janë gjithmonë të orientuara kah folklori i traditës, kah krijimet e folklorit në të kaluarën dhe vlerat “e mirëfillta” që kishte ai. Kjo mund të dëshmohet qartë nga studimet për folklorin shqiptar që botohen në Prishtinë e Tiranë, të cilat gjithmonë pikë referimi i kanë temat historike në folklor si p.sh. këngët për Rilindjen kombëtare, strukturën e këngëve të nizamëve, figurat historike të qëndresës kombëtare gjatë pushtimeve osmane⁷, apo këngët popullore për Lidhjen shqiptare të Prizrenit, këngët mbi luftën e shqiptarëve për çlirim kombëtar, baladat dhe përbërësit mitikë në to, lidhjen e baladave me këngët kreshnike⁸ etj. Gjithashtu edhe tek studimet mbi prozën gojore, edhe kur ato janë të orientuara kah studimet teorike të zhanreve, lënda që merret në trajtim është nga krijimet tradicionale p.sh. merren në shqyrtim përrallat me

⁶ Alan Dundes, *Interpreting Folklore*, Bloomington: Indiana University Press, 1980. Fq. 12.

⁷ Adem Zejnullahu, *Këngë dhe shkrime*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2009.

⁸ Sadri Fetiu, *Balada popullore shqiptare*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2000 dhe *Folkloristikë*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2009.

përbërësit mitikë, lidhjet e përrallës me gojëdhënat etj.⁹ Në studimet e tjera ku bëhet kërkimi i autenticiteti folklorik tek zhanret e ndryshme, ai gjithmonë matet në raport me karakterin e tij historik, duke insistuar kështu në idenë se vlerat e vërteta të folklorit janë vetëm ato që mbesin pas filtrimit që iu bëhet gjatë një qarkullimi të caktuar në kohë¹⁰. Në këtë kontekst, edhe studimet që bëhen për ndonjë zhanër të caktuar nga letërsia gojore, apo edhe vetëm për një figurë stilistike¹¹ në këtë letërsi¹², lënda që do të merret në trajtim është gjithmonë ajo që i ka mbijetuar filtrit kohor.

Folkloristika, si një disiplinë shkencore për studimin e folklorit, vazhdon të funksionojë vetëm në ndërlidhje me letërsinë, me shkencën letrare, por pa u bërë asnjëherë përpjekje të kombinohet me shkenca të tjera si sociologjia, filozofia, psikologjia, religjioni, politikologjia, e shkenca të tjera, të cilat duke i ndihmuar zbërthimit të fenomeneve të veta, por edhe të folklorit, do ta pasuronin shumë zhvillimin e tyre dhe gjithashtu do të gjenin përgjigje në shumë çështje të vetat problemore.

Një çështje tjetër që ndërlidhet me problemin e kësaj discipline tek studimet shqiptare është çështja e definimit të materies. Duke u nisur nga koncepti mbizotërues në këto studime se **folklori është art letrar** dhe se me të duhet të merret pak letërsia, por jo disiplinat e tjera, madje as etnologjia, vijmë te përgjigja se ky koncept folklorin e sheh vetëm si tekst, por jo edhe si kulturë (materiale dhe shpirtërore), jo edhe si shprehje sociale, as rrethanore, as historike, as interaktive etj. nuk e sheh si performansë, si një tërësi formash shprehëse, por e redukton vetëm në aspektin letrar dhe gojor, dhe atë vetëm artistik. Përderisa Folkloristika evropiane dhe ajo botërore, e ka tejkaluar prej më se një gjysmë shekulli (diku më pak e diku më shumë se aq) këtë definicion të folklorit, ne vazhdojmë ta shohim *vetëm si art i fjalës*, ta mbledhim *vetëm si tekst* dhe ta analizojmë *vetëm nga aspekti teorik-letrar*. Definicioni se “Folklori është i pranishëm në shumë forma të komunikimit informal, qoftë ky verbal, (i folur ose i shkruar), zakonor (sjelljet, ritualet) ose material (objektet fizike), për njerëzit dhe për mënyrën se si ata mësohen, që na ndihmon ta njohim

⁹ Myzaferë Mustafa, *Proza gojore: teksti dhe konteksti*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2005.

¹⁰ Agron Xhagolli. Në kërkim të autenticitetit folklorik, në *Letërsi folklorike*, Agron Xhagolli, Ramazan Bogdani, (ribotim) Buzuku, Prishtinë, 1996.

¹¹ Zymer Neziri, *Poetika e krahasimit*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2004.

¹² Miaser Dibra, *Metafora në këngët popullore shqiptare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2007. Rustem Berisha, *Stili dhe figuracioni i poezisë popullore shqiptare*, instituti Albanologjik, Prishtinë, 1986.

veten dhe ta kuptojmë botën që na rrethon”¹³, i cili e ka përfshirë sot folkloristikën ndërkombëtare dhe është i pranishëm si koncept tek pothuajse të gjitha institucionet akademike që merren me studimin e folklorit, ende nuk ka arritur në Folkloristikën shqiptare. Idetë se folklori është i pranishëm kudo, në qytete, lagje, fshatra, familje, grupe të punës dhe konvikte, se nuk është i pranishëm vetëm tek të paarsimuarit, se nuk është vetëm një formë tjetër e antropologjisë ose e studimit letrar, se nuk është “kulturë popullore”, se nuk është krijim vetëm i shtresave të caktuara: fshatare, elitare, zyrtare etj., se nuk duhet patjetër të bartet nga brezat, se nuk është e domosdoshme të jetë art sinkretik, janë ide që nuk gjenden tek studimet shqiptare të folklorit. Përderisa zhvillimet akademike të folkloristikave botërore, të cilat vijnë si rezultat i zhvillimeve të vazhdueshme të lëndës së folklorit në terren dhe i nevojës së disiplinës për përparim të vazhdueshëm të metodave dhe qasjeve, folklorin e definojnë: “Folklori është njohuria jozyrtare që e kemi fituar në mënyrë jo shkollore për botën, veten tonë, për komunikimin tonë, besimet tona, kulturat dhe traditat tona, dhe që e shprehim në mënyrë kreative nëpërmjet fjalëve, muzikës, zakoneve, veprimeve, sjelljeve dhe kulturës materiale. Është gjithashtu një proces krijues interaktiv dhe dinamik i komunikimit dhe paraqitjes së këtyre njohurive tona në raport me të tjerët”¹⁴. E një koncept i këtillë nuk ekziston as si teori e as si praktikë në hulumtimet, por as në studimet shqiptare të folklorit, as në Kosovë as në Shqipëri.

Vendi i disiplinës së Folkloristikës në programet e studimeve akademike

Përveç konceptit të materies, një çështje tjetër problemore në Folkloristikë, është vendi që i është lënë kësaj discipline në programet akademike të fakulteteve në kuadër të universiteteve publike. Po e marrim në trajtim Universitetin e Prishtinës, i cili është universiteti më relevant publik kur dihet se të gjitha universitetet e tjera publike që po formohen viteve të fundit në Kosovë, i marrin programet prej tij, përderisa universitetet private as që e kanë të përfshirë në programet e tyre folklorin dhe folkloristikën, as si lëndë hulumtuuese as si disiplinë a njësi akademike. Atëherë kur i marrim parasysh programet e studimeve në

¹³ Martha Sims & Martine Stephens, *Living folklore*, Utah State University Press, Logan, 2005, fq.2.

¹⁴ Po aty, fq. 8

fakultetet e Universitetit të Prishtinës, e shohim se Folklorit(stikës), i është bërë një vend minimal ose nuk i është bërë vend fare. I marrim në shqyrtim programet e dy fakulteteve, ku mund të merren parasysh si njësi akademike ku “përmendet” lënda e folklorit, e që këto fakultete janë Fakulteti i Filologjisë dhe Fakulteti Filozofik.

Në Fakultetin e Filologjisë, lënda e folklorit, gjegjësisht *Letërsia popullore* (pasi që siç thamë në shkollat shqiptare të Kosovës folklori pranohet vetëm për aspektin e tij letrar) është lëndë që hyn në programin e studimeve të Departamentit të Letërsisë shqipe si edhe atij të Gjuhës shqipe¹⁵. Në Programin e Letërsisë shqipe të nivelit Bachelor që i ka tetë semestra, studentët e dëgjojnë lëndën *Letërsi popullore* në dy semestrat e parë si lëndë obligative dhe lëndën *Folklori arbëresh* në semestrin e katërt, por këtu e ka statusin e lëndës zgjedhore. Gjithashtu në të njëjtin fakultet, në programin e Gjuhës shqipe, në semestrin e katërt lënda *Letërsi popullore* është pjesë e grupit të lëndëve me zgjedhje, pra jo e obligueshme. Departamenti i Letërsisë, niveli Bachelor, e ka programin katërvjeçar me gjithsejtë tetë semestra dhe aty studenti i dëgjon mbi njëzet lëndë nga fusha e Letërsisë së shkruar (Letërsi e vjetër shqipe, Letërsi për fëmijë, Letërsi paramoderne, Letërsi romantike arbëreshe, Sociologji e letërsisë, Letërsi romantike, Analizë e tekstit letrar, Letërsi botërore, Teori e vargut, Poetikë, Analizë e zhanreve letrare, Kritikë letrare, Estetikë, Narratologji, Romani shqiptar etj.) si edhe disa nga fusha e gjuhësisë (Morfologji, Fonetikë, Semiologji, Sintaksë) e të tjera nga fusha e kulturës, por vetëm një e ka nga folklori dhe atë vetëm nga ai letrar (*Letërsi popullore*), duke mos i llogaritur shumë *Folklorin e arbëreshëve* dhe *Teoritë e folklorit*, të cilat janë me zgjedhje dhe studenti shumë pak ka gjasa t’i zgjedhë ato. E çfarë studime letrare pretendohet të jenë këto, kur studentët “specializohen” në teoritë moderne e ultra-moderne të letërsisë së shkruar, por nuk e njohin “folklorin që është mitra prej nga ka lindur vetë letërsia”¹⁶.

Që të tri këto lëndë, njëra obligative dhe dy zgjedhore (ku studenti duhet ta zgjedhë vetë), që mësohen në fillim të studimeve, janë tepër pak për të mos thënë janë aspak, që të ndikojnë për të ndërtuar një folklorist. Le ta zëmë se nuk duhet të pretendojmë të nxjerrim specialistë me studime Bachelor, por studentët duhet të vazhdojë studimet Master për të

¹⁵ Programi i studimeve, Departamenti I Letërsisë shqipe, Universiteti i Prishtinës, <http://filologjia.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti02.aspx> (23.XII.2013)

¹⁶ Vladimir Propp, *Theory and History of Folklore*, trans. By A. Martin & R. Martin, University of Minnesota Press, Mineapolis, fourth printing, 1997, fq. 14.

fituar specialitet të studimeve, respektivisht për të marrë orientim kah studimi i një fushe. Atëherë shtrohet pyetja: si do të zgjedhë të studiojë Folkloristikën një student që për këtë fushë iu ka shtruar vetëm një provimi në vitin e parë? Si do të provokohet ai student për studimin e folklorit me aq pak dije që merr ai nga niveli Bachelor? Rrjedhimisht nga këto rezultate del se Fakulteti i Filologjisë nuk përgatitë folkloristë dhe se prej këtij fakulteti nuk dalin specialistët e folklorit. Studentët e nivelit Bachelor marrin shumë pak njohuri (dhe ato shumë të përgjithshme) nga folkloristika, e nëse ndodh që zgjedhin edhe dy lëndët e tjera të sipërpërmendura, ato nuk mjaftojnë për të ngjallur interesimin dhe për t'i orientuar ata kah specializimi në këtë fushë. Thënë shkurt, rruga e vetme për përgatitjen e një folkloristi në Kosovë, mbetet ajo e autodidaktit.

Kalojmë atëherë tek një departament tjetër, ai i Etnologjisë, që si lëndë studimi do të duhej ta përmbante edhe folklorin. Ndoshta aty mund të ndërtohet folkloristët. Është pra Fakulteti Filozofik i cili në kuadër të vetin e ka Departamentin e Etnologjisë me programin e studimeve të nivelit Bachelor të emërtuar “Etnologji dhe Antropologji kulturore”¹⁷, program ky që të bën të besosh se e ka në kuadër të vetin lëndën e folklorit. Mirëpo, ky program tre vjeçar, gjashtë semestral, në kuadër të të cilit përfshihen lëndë nga Antropologjia (A. kulturore, A. e religjionit, A. gjinore, A. e Evropës, A. e Evropës juglindore, A. vizuale, A. urbane dhe A. e krijimtarisë dhe e memories) dhe Etnologjia (Hyrje në Etnologji, E. shqiptare, E. juridike, Teoritë etnologjike, etj.) si edhe shumë lëndë të tjera si Historia e popullit shqiptar, Etnokoreologjia e kultura materiale, nuk ka asnjë lëndë nga Folklori a Folkloristika. I gjejmë dy lëndë që ndoshta mund të kenë brenda vetes folklorin siç është Etnomuzikologjia dhe Mitologjia krahasimtare, por gjithashtu nuk kanë të bëjnë me studime të mirëfillta nga fusha e Folkloristikës. Po ashtu, është e çuditshme mbi çfarë baze është bërë përzgjedhja e lëndës Mitologjia krahasimtare? Për çfarë krahasimi është fjala, apo krahasim me çfarë mitologjie, kur nuk figuron asnjë lëndë nga Mitologjia shqiptare? Si mund të fitojë student njohuri krahasuese pa e njohur bazën krahasuese? Mbetet shumë i çuditshëm kombinimi i këtij programi, me mungesë të dukshme të lëndëve nga folklori. Studentët që dalin nga ky fakultet, dalin me një hendikep të madh nga folklori, teoritë dhe metodat e punës me të, dhe ky problem rritet edhe më shumë kur këtyre studentëve u duhet të vazhdojnë studi-

¹⁷Programi i studimeve. Departamenti i Etnologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës, <http://filozofiku.uni-pr.edu/getattachment/Departamentet/Departamenti09/Orari-i-departamentit-te--Etnologjise.pdf.aspx> (23.XII.2013).

met Master. Ky departament nuk organizon studime Master, dhe studentët etnologë-antropologë, detyrohen të shkojnë dhe të vazhdojnë studimet Master në Tiranë në Qendrën e Studimeve Albanologjike, ku organizohen studimet Masterit dhe ato të Doktoratës nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit (ish Instituti i Kulturës Popullore). Në këtë Institut të riorganizuar në tri departamente, dy prej tyre janë: 1. Departamenti i Folklorit me sektorët Folklor gojor dhe Etnomuzikologji dhe 2. Departamenti i Etnologjisë me sektorët Etnologji materiale dhe Etnologji shpirtërore¹⁸. Programet e këtyre studimeve i kanë shumicën e lëndëve të përbashkëta, sidomos ato nga folklori, etnologjia e antropologjia e përgjithshme, dhe tani bëhet problem për studentët që shkojnë nga Kosova, sepse dijet e tyre nga fusha e folklorit janë tepër të kufizuara ose mungojnë fare. Studentëve nga Kosova u duhet t'u kthehen dijeve bazike nga folklori shqiptar, por edhe çështjeve të tjera nga teoritë dhe metodat, për shkak se e kanë përfunduar drejtimin e Etnologjisë, pa marrë dije nga Folkloristika. Dhe në marrjen e këtyre dijeve atyre u duhet të bëjnë punë autodidakti, pavarësisht se janë etnologë me diplomë. Më pas ata do të marrin edhe gradën Master, por tani nga Departamenti i Folklorit gojor, p.sh. të lëshuar nga Qendra e studimeve albanologjike në Tiranë. Atëherë këtu shtrohet pyetja: çfarë specialistësh do të jenë ata? Etnologë, folkloristë, specialistë nga të dyja fushat apo nga asnjëra? Realisht nuk do të duhej as të shtrohej kjo pyetje si çështje, pasi që vetë objekti i studimit nuk mund të ndahet, por ndarjet që bëhen që në orientimet bazike fakultative të shtyjnë detyrimisht në ndarje e veçime të këtilla.

Për të mos ngelur vetëm në nivelin e kritikës, zgjidhja e kësaj problematike, në rastin më të mirë do të bëhej me hapjen e një Departamenti të Folkloristikës. Përderisa është arsyetuar hapja e një departamenti të veçantë nga Etnologjia dhe Antropologjia kulturore në kuadër të Universitetit të Prishtinës pse të mos jetë edhe një i tillë edhe nga Folkloristika? Ky departament më së miri do të funksiononte në kuadër të Fakultetit të Filologjisë ku krahas lëndëve mbi *Teoritë e folklorit* do të përfshiheshin edhe lëndë si: *Zhanret e folklorit dhe historia e studimeve; Folklori dhe trendët kulturore; Folklori dhe nacionalizmi; Studimet paremiologjike; Historia gojore në studimet e folklorit; Hulumtimet dhe materialet e historisë gojore; Historia gojore: teoritë dhe metodat; Rrëfimi dhe tradita narrative; Identiteti etnik dhe trashëgimia kulturore;*

¹⁸ Qendra për Studime Albanologjike, Tiranë http://www.qsa.edu.al/index.php?option=com_content&view=article&id=82&Itemid=109&lang=sq (23.XII.2013)

Mendësia (mentaliteti) popullor; Studimi i religjionit popullor; Muzika popullore; Mjekësia popullore; Metodat e hulumtimit të folklorit; etj. Kjo do të ishte zgjidhja primare, përderisa do të mund të gjendej edhe një zgjidhje dytësore, ku në pamundësi për të hapur departament të ri, programit ekzistues do t'i shtohen disa nga lëndët e sipërpërmendura, ashtu që së paku të pasurohej programi nga fusha e folkloristikës dhe në këtë mënyrë të zhvillojë tek studentët interesimin për t'u orientuar në Folkloristikë. Gjithashtu, modifikimet mund të bëheshin edhe në kuadër të Departamentit të Etnologjisë dhe Antropologjisë kulturore, pavarësisht se aty do të gjendeshin justifikime të tipit “ne e trajtojmë folklorin në kuadër të Antropologjisë kulturore”. Në këtë departament folkloristika do të zinte vendin e vet në kuadër të lëndëve ku trajtohen problemet nga oraliteti, tradita, performansa gjithmonë brenda kontekstit të antropologjisë dhe etnologjisë, por kuptohet si njësi të veçanta. *Historia dhe teoria e folklorit*, por edhe *Historia gojore, Metodat e hulumtimit të folklorit, Mendësia popullore* e ndonjë tjetër do të përshtateshin shumë mirë në kuadër të etnologjisë dhe antropologjisë.

Përvoja nga shkollat e Folkloristikës në rajon dhe më gjerë

Në kuadër të trajtimit të zgjidhjeve për këto problematika, afrohemi tek një çështje tjetër, e cila na intrigon për zgjerimin e kufijve të konceptit të Folkloristikës shqiptare, meqenëse shumë herë kufijtë ekzistues mund të jenë pengesa kryesore për zhvillimin dhe avancimin e disiplinës. Në përvoja të këtilla kanë kaluar shumë shkolla akademike, të cilat për hir të zhvillimit të disiplinës, është dashur ta zgjerojnë atë. Përmendim këtu përvojën nga shkolla finlandeze (si përvojën më të afërt të njohur që kam), shkolla me katedrën më të vjetër të Folkloristikës në botë (që nga 1908), e cila në periudhën e industrializimit, por më pas edhe të depërtimit të trendeve të shumta në jetën kulturore dhe akademike finlandeze, duke e parë që bota shpirtërore shprehëse e finlandezëve po “modifikohet” nga ndikimet e mundësive të reja dhe të ndryshme shprehëse, u organizua në formë tubimi sensibilizues të folkloristëve akademikë, për të shqyrtuar kufijtë ekzistues të disiplinës. Me këtë rast, prof. Maatti Kuusi që ishte në krye të katedrës propozoi që studimet e folklorit kombëtar të orientohen drejt studimeve krahasimtare, duke i hapur kështu mundësitë në studimin e folkloreve të popujve të tjerë në përqasje me atë finlandez, si edhe propozoi që në objektin e studimit të folklorit të hyjnë edhe kultura popullarizuese, mas media dhe interneti si edhe kultura e të rinjve. Këto ndryshime që i bëri Folkloristika finlandeze

në vitet '60 të shekullit të kaluar, lëvizje këto që u bënë në mënyrë institucionale dhe sistematike, ia zgjeruan kufijtë disiplinës duke i bërë kështu subjekte studimi shumë fusha të patrajtuara deri atëherë, por edhe duke e modernizuar qasjen dhe pasuruar lëndën e Folkloristikës njëkohësisht. Padyshim që kjo pastaj i dha mundësi specializimit të ngushtë të çështjeve të caktuara nga folkloristë individë, të cilët nëpërmjet adaptimit të metodave hulumtuese në lëndët e reja të folklorit, i dhanë mundësi edhe përparimit të disiplinës¹⁹.

Një njohuri e ngjashme na vije nga Sllovenia, me përvojën e folkloristes dhe etnomuzikologes prof. Zmaga Kumar, e cila në studimet e veta, duke e parë disiplinën ekzistuese të Folkloristikës sllovene, e cila me kufijtë e saj konceptuale nuk po i "shkonte për shtati" materialeve në terren si edhe trendeve të reja metodologjike, u vu para dilemës "Ç'të bëjmë me folklorin?". Pra çështja ishte ç'të bëhet me disiplinën, të përfundohet si e tillë apo t'i zgjerohen kufijtë ekzistues dhe t'i jepet rast pasurimit të lëndës hulumtuese duke u bërë kështu zhvillimi i më tutjeshëm i vetë disiplinës. Sigurisht se do të fitojë e dyta kur edhe folkloristika sllovene do të përfshijë në domenin e saj traditën folklorike të kombeve, etniciteteve dhe grupeve; globalizmin dhe sfidat që i imponon ai në kapërcimin e kufijve kulturorë; format e reja të folklorit; folklorizmin; metodat e dokumentimit, arkivimit dhe hulumtimit të folklorit; si edhe padyshim marrëdhëniet e pashkëputshme të folklorit me letërsinë, por duke i parë kundrejt njëri tjetrit si p.sh. a janë folklori dhe letërsia "kushërinj konkurrentë"?, si qëndron balada popullore kundrejt baladës letërore?, etj.²⁰

¹⁹ Shih më tepër Pekka Hakamies, Oral History-A new paradigm in Finnish Folkloristics. *Etnichna istorija narodiv Evropy*, fq. 6. http://www.history.univ.kiev.ua/ethnology/journal/ethnic_history_14/14_1.pdf (23.XII.2013)

²⁰ Me rastin e ndarjes nga jeta të prof.dr. Zmaga Kumer (1924-2008), Instituti për Etnomuzikologji dhe Folklor në kuadër të Akademisë Sllovene të shkencave, në shtator të vitit 2009, në Lubljanë organizoi Simpoziumin shkencor ndërkombëtar me titullin "Çka të bëjmë me folklorin?" (What to do with folklore?), që ishte thënia e njohur e prof. Kumer, me çka kujtohej puna e saj në Folkloristikën sllovene, por njëkohësisht edhe problematikat e definimit të disiplinës, në Slloveni dhe jashtë saj. Pjesëmarrja e studiuesve nga shumë vende të Evropës, ku shprehën dilemat lidhur me kufijtë e disiplinës, tek kulturat e veta, i tregoi edhe më shumë hapat e zhvillimit të kësaj discipline, e cila nuk mbetet pa sfida. Për më tepër shih Aktet e këtij takimi <http://trove.nla.gov.au/ëork/152143318?q=subject%3A%22Folklore+Slovenia+Abstracts+of+conference+proceedings.%22&l-format=Conference+Proceedings&c=book&versionId=165839563> (23.XII.2013)

Shembull të një përvoje tjetër e marrim nga Instituti i Folklorit në Sofje të Bullgarisë, i cili bashkë me Institutin dhe Muzeun Etnografik veprojnë nën Akademinë Bullgare të Shkencave. Ky institut në themelimin e tij më 1973 pati tri departamente: Departamentin e Folklorit gojor; Departamentin e Teorisë dhe Estetikës së Folklorit; dhe Departamentin e Artit popullor. Më 1986 u hap edhe Departamenti i Folklorit ballkanik dhe sllav. Mirëpo kjo strukturë nuk mbeti e pandryshueshme deri sot. Në vitin 2006, duke i parë ndryshimet në terren si edhe në metodologjinë e hulumtimeve, Instituti i Folklorit u ristrukturua, duke u modifikuar departamentet ekzistuese në katër departamente të reja me emërtimet: Antropologjia dhe traditat verbale; Antropologjia e Muzikës dhe e Valleve; Antropologjia e Artit Popullor dhe e Formave vizuale; Folklori Ballkanik dhe sllav dhe duke e hapur departamentin e ri “Qendra kombëtare e trashëgimisë kulturore të paprekshme”. Sigurisht se punonjësit shkencorë, vazhdonin të ishin po ata, me specializimet veta, por pasurimi i qasjeve dhe metodave vazhdonte të bëhej gjithashtu, duke iu dhënë mundësi atyre të angazhoheshin në projekte të reja që kishin kërkesa për orientime, qasje e metoda të reja, gjë që e bënë nëpërmjet punës së vazhdueshme në terren si edhe nëpër programe të reja akademike, por risitë hynë edhe nëpërmjet angazhimeve të studiuesve të rinj, të cilëve u mundësohej edhe të aftësoheshin në institucione të tjera jashtë Bullgarisë. Por, e veçanta e këtij Instituti është se prej vitit 2004 organizon studime të doktoraturës, me ç’rast vetë kuadri akademik i këtij institucioni përgatitë kandidatët potencialë për specialistë në fushat e sipërpërmendura. Programet e doktoraturës që organizohen në këtë institut janë nga fushat: Studimet të folklorit; Teori e Muzikës dhe e Artit muzikor e atij të valleve si edhe Studime të Artit dhe Arte vizuale. Për çdo dy vjet pranohen një numër i caktuar, jo i madh, i kandidatëve për doktoraturë, të cilët përgatiten nga mentorë adekuatë për fushat të ngushta të disiplinave.²¹

Sipas këtij modeli, ku Instituti i Folklorit, krahas aktivitetit kërkimor e shkencor dëshmohet edhe në atë të mësimdhënies, duke iu mundësuar kështu kuadrit shkencor të aftësojë specialistë të fushave të ngushta, e shohim se viteve të fundit po funksionon edhe Instituti i Kulturës Popullore në Tiranë (sot Instituti për Antropologji dhe Studimin e Artit), i cili është reformuar duke hyrë në kuadër të Qendrës së Studimeve Albanologjike bashkë edhe me shumë institute të tjera, që bazë

²¹ Shih më tepër në web-faqen e Institutit të Folklorit Sofje, Bullgari http://folklor.bas.bg/edu_en.html (23.XII.2013)

studimi e kanë kulturën kombëtare. Në këtë institut, siç e përmendëm edhe më lartë në një kontekst tjetër, sot veprojnë tri departamente: Departamenti i Folklorit me sektorët: Sektori i Folklorit gojor dhe Sektori i Etnomuzikologjisë; Departamenti i Etnologjisë me sektorët: Sektori i Etnologjisë Materiale dhe Sektori i Etnologjisë Shpirtërore, si edhe Departamenti i Studimit të Artit²². Edhe këto departamente, si të tilla, u reformuan viteve të fundit, përderisa nuk e kishin që moti këtë emërtim as edhe këtë strukturë, por që si të tilla çdo herë e më tepër po përpiqen që të kapin hapin në raport me rrjedhat e zhvillimeve në rajon, nëse jo gjithmonë në cilësi, shpresoj që ky të jetë synim i tyre në vazhdimësi.

Në vend të përfundimit

Duke pasur mundësinë që të përcjellim hapat dhe trendet e zhvillimeve të folkloristikave jo shqiptare, në rajon por edhe më gjerë, sot nëpërmjet internetit, por edhe nëpërmjet mundësive të studimeve në institucionet jashtë vendit, nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca, nëpërmjet përdorimit të literaturës që botohet jashtë, por edhe nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me kolegët joshqiptarë, mundësi këto që janë tërësisht të ndryshme nga ato të para pesëdhjetë viteve në Folkloristikën shqiptare, pse ne hezitojmë të jemi të ndryshëm nga brezat para nesh? Pse vazhdojmë të mos lëvizim nga binarët e trasuar nga brezat e kaluar? Pse vazhdojmë të mjaftohemi me ato që janë bërë në Folkloristikën shqiptare? Pse madje shkojmë edhe më prapa tyre, në vend se të shkojmë hapa përpara, duke e reduktuar mundësinë e kësaj disipline në hapësirën akademike? Pse hezitojmë dhe ngurrojmë ta përparojmë këtë disiplinë? Pse jemi kaq dorështrënguar, por edhe të pavullnetshëm, në zhvillimin e saj (Folkloristikës), përderisa vazhdojmë ta prodhojmë këtë materie (folklorin) çdo here e më shumë në përditshmërinë tonë?

Që të mos ngelim duke pyetur dhe pa marrë përgjigje, pas paraqitjes së kësaj problematike, por edhe modeleve nga jashtë, do të ishte mirë të përpiqemi për disa ndryshime, pasi që koha është, por edhe nevoja gjithashtu. Ideja për një takim profesional të studiuesve të folklorit nga të gjitha institucionet akademike shqiptare, ku do të debatoheshin çështjet terminologjike, konceptuale e strukturore të kësaj disipline ndër ne, por edhe ku do të merrte kahje dhe orientim sistemi i hulumtimeve

²²Shih më tepër në web-faqen e Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë http://www.qsa.edu.al/index.php?option=com_content&view=article&id=82&Itemid=109&lang=sq (23.XII.2013)

dhe studimeve të ardhshme të kësaj disipline, është urgjente. Takimi ose disa takime të këtilla, me profesionistë të nivelit akademik, do të mundësonin koordinimin e shkollave shqiptare të Folkloristikës, duke i dhënë kështu rast studimeve sistematike dhe të harmonizuara me trendët në rajon e më gjerë. Përderisa shkencat e tjera albanologjike, siç është Gjuhësia në këtë rast, e shohin të nevojshme të realizojnë plane të këtilla nëpërmjet krijimeve dhe takimeve më pas të Këshillave ndërakademike ku i diskutojnë dhe merren për çështjet e debatueshme nga fusha e vet, pse folkloristët nuk e ndjejnë të nevojshme, aq më tepër kur i shtojmë këtyre trendëve të reja në rajon e më gjerë, edhe ndryshimet e mëdha që i kanë pësuar shqiptarët, në aspektin e integriteteve shoqërore e kulturore por edhe në atë të mundësive të reja të komunikimit brendashqiptar, në njëzet vitet e fundit?

Më pas, koordinimi i programeve të studimeve në nivelet akademike, qoftë edhe duke i dhënë veçanti cilësore njëres shkollë nga tjetra, me qëllim pasurimi të shkollave dhe metodave, do të ndikonte në aftësimin e drejtë dhe të saktë të profesionistëve, në këtë rast folkloristëve, antropologëve, etnologëve e studiuesve të tjerë të këtyre fushave. P.sh. shkolla e Tiranës mund të vejë theksin në studimet e bazuara në materialet arkivore për shkak të lëndës së pasur që ka në arkivin e Institutit, përderisa shkolla e Kosovës, mund të vejë theksin tek studimet e performansës, për faktin se terreni në Kosovë ende ofron mundësinë e regjistrimit të performansës së gjallë, siç është rasti me këngët epike. Apo, p.sh. për shkak të materialit të pasur nga repertori i grupeve të shumta të muzikës urbane, që janë më dominuese në Kosovë, kjo shkollë mund të zhvillojë orientimet e studimeve kah një koncept më i zgjeruar i Folkloristikës, duke i dhënë hapësirë në këto studime edhe aspekteve të tjera të kulturës, zhvillimeve sociale e teknologjike, dhe duke i marrë parasysh si materiale studimi, për ta modernizuar vetë konceptin për Folkloristikën shqiptare.

Mirëpo, pa asnjë dyshim, baza e shëndoshë e tërë këtij përparimi, është hapja e një departamenti të veçantë të Folkloristikës, sipas modeleve në rajon e Evropë, i cili do të përgatiste specialistë për studimin e folklorit, duke e pasur në programin e vet, metodologjinë hulumtuese e kërkimore të orientuar jo vetëm kah aspekti letrar e historik i folklorit, kryesisht nëpërmjet metodës deskriptive siç bëhet deri më tash, por edhe ai performues, kontekstual, struktural, tekstual, arkivor etj. Ky do të ishte variant më i mirë, më i nevojshëm dhe më i pranueshëm, mirëpo në rast pamundësie, edhe aktivizimi i shkollës hulumtuese shkencore në Departamentin e Folklorit të Institutit Albanologjik, ku do të përgatiteshin kan-

didatë për studimet Master e ato të Doktoraturës, sipas modelit bullgar për shembull, do të mund të merrej parasysh, por gjithmonë duke siguruar një program studimesh të avancuar që do dëshmonte përgatitjen e folkloristëve në nivel të barabartë me kolegët në rajon. Të mos harrojmë që qëllimi kryesor i këtyre studimeve është arritja e përgatitjes së specialistëve për t'u ranguar në nivel me kolegët në rajon e më gjerë, pasi që asgjë më shumë se hapja me botën përtej komunikimit vetëm kombëtar, nuk do ta zhvillojë Folkloristikën dhe as asnjërën shkencë tjetër. Sigurisht që hapja dhe përzgjedhja e programeve në shkollat akademike, do të duhej të bëhej në bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve të Tiranës e Prishtinës, si më kryesoret, por edhe Shkupit, Tetovës, Prizrenit e universiteteve të tjera më të vogla shqiptare, ashtu që kandidatët në rastin e orientimit për të vazhduar studimet në shkollat shqiptare, të mos e kenë të detyrueshme të shkojnë në Tiranë, për shkak se nuk ka në Prishtinë programe për Master e për Doktoratë, por të bëjnë zgjedhjen mbi bazën e programeve që ofrojnë këto dy shkolla shqiptare, apo edhe të tjera në universitete të tjera tonat. Kuptohet që e tërë kjo kërkon vullnet e punë serioze dhe strategji të nivelit akademik shqiptar.

ACTUAL PROBLEMS OF ALBANIAN FOLKLORISTIC

Summary

In this paper I tried to see the status of the discipline of Folkloristics (academic discipline for the study of folklore) today, compared with the past when it was founded until today as we know the situation. By analyzing the circumstances, no favorable, in which it is functioning today, as well as providing examples from local and international practice, I tried to show the opportunity to change this situation. A change of its status to good, is necessary given that the matter itself (folklore) is created constantly, while the discipline of study, the Folkloristics, each time its space is more narrowed. There is needed changing of theoretical approach, enabling the shifting of focus from "the study of the past" to "new contemporary processes". Ideas remain open, because changes from within, need, readiness and professional preparation of the group, not the individual.

Referencat bibliografike dhe burimet nga interneti

Aktet nga Konferenca nderkombëtare “What to do with folklore?”
Ljubljana, shtator 2009.

<http://trove.nla.gov.au/work/152143318?q=subject%3A%22Folklore+Slovenia+Abstracts+of+conference+proceedings.%22&l-format=Conference+Proceedings&c=book&versionId=165839563> (23.XII.2013)

Berisha, Rrustem, *Stili dhe figuracioni i poezisë popullore shqiptare*, 1986, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Berisha, Rrustem, Ndihmesa e Anton Çettës për punën e Degës së Folklorit, *Anton Çetta, figurë poliedrike e kulturës shqiptare*, 2011, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Dibra, Miaser, *Metafora në këngët popullore shqiptare*, 2007, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

Dundes, Alan, *Interpreting Folklore*, 1980, Bloomington: Indiana University Press.

Tridhjetë vjet të Institutit Albanologjik (1967-1997), 1997, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Fetiu, Sadri, *Balada popullore shqiptare*, 2000, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Fetiu, Sadri, *Folkloristikë*, 2009, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Hakamies, Pekka, “Oral History—A new paradigm in Finnish Folkloristics,” 2013, *Etnichna istoriia narodiv Evropy*,

http://www.history.univ.kiev.ua/ethnology/journal/ethnic_history_14/14_1.pdf (23.XII.2013)

Instituti i Folklorit, Sofje, Bullgari

http://folklor.bas.bg/edu_en.html (23.XII.2013)

Mustafa, Myzafere, *Përralla shqiptare - poetika dhe mitikja*, 2003. Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Mustafa, Myzafere. *Proza gojore: teksti dhe konteksti*, 2005, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Mustafa, Myzafere, Kontributi i prof. Anton Çettës në mbledhjen dhe studimin e letërsisë gojore, Anton Çetta, figurë poliedrike e kultures shqiptare, 2011, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Neziri, Zymer Ujkan, *Poetika e krahasimit*, 2004, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Programi i studimeve, Departamenti i Etnologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës,

<http://filozofiku.uni-pr.edu/getattachment/Departamentet/Departamenti09/Orari-i-departamentit-te--Etnologjise.pdf.aspx> (23. XII.2013).

Programi i studimeve, Departamenti i Letërsisë shqipe, Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës,

<http://filologjia.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti02.aspx> (23.XII.2013)

Propp, Vladimir, *Theory and History of Folklore*, 1997, trans. Ariadna Y. Martin & Richard P. Martin, Minneapolis: University of Minnesota Press.

Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

http://www.qsa.edu.al/index.php?option=com_content&view=article&id=82&Itemid=109&lang=sq (23.XII.2013)

Sims, Martha C. & Martine Stephens, *Living Folklore: an Introduction to the Study of People and their Traditions*, 2005, Logan, UT: Utah State University Press.

Shala, Demush, *Letërsia popullore*, 1988, Prishtina: ETMM i KSAK.

Uçi, Alfred, *Estetika e Folklorit*, 2007, Tirana: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Xhagolli, Agron , Në kërkim të autenticitetit folklorik, *Letërsi folklorike*, 1996, Agron Xhagolli, Ramazan Bogdani, (ribotim) Buzuku, Prishtinë.

Zejnullahu, Adem, *Këngë dhe shkrime*, 2009, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

